



ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI  
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU  
ENERGY REGULATORY OFFICE

## **RREGULLA PËR KUSHTET E PËRGJITHSHME TË FURNIZIMIT ME ENERGJI**

Prishtinë, shkurt 2017

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, sipas autoritetit të dhënë me Nenin 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 i Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr. 05/L-084, dhe neni 46.3, 52.1 dhe 55 i Ligjit për Energjinë Elektrike dhe Neni 34, paragrafin 1.5 të Ligjit për Energjinë Termike në seancën e mbajtur me \_\_\_\_\_miratoi:

## **RREGULLËN PËR KUSHTET E PËRGJITHSHME TË FURNIZIMIT ME ENERGJI**

### **KREU I**

#### **DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

##### **Neni 1**

##### **Qëllimi**

Qëllimi i kësaj rregulle është përcaktimi i kushteve të përgjithshme të furnizimit me energji, si dhe detyrat dhe obligimet e ndërmarrjeve energjetike dhe konsumatorëve. Në këtë Rregull përshkruhen parimet e përgjithshme të kyçjes (aplikimi për kyçje, oferta, marrëveshja për kyçje dhe furnizim) dhe shfrytëzimit të sistemit, leximit, matjes, faturimit dhe arkëtimit, si dhe shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë.

##### **Neni 2**

##### **Fushëveprimi**

1. Dispozitat e rregullës janë të aplikueshme për ndërmarrjet e energjisë që ofrojnë shërbime të energjisë dhe bëjnë furnizimin me energji (në tekstin në vazhdim “ndërmarrjet e energjisë”), dhe për konsumatorët fundorë që shfrytëzojnë këto shërbime dhe energjinë (në tekstin në vazhdim “konsumatorët”).
2. Kushtet e përgjithshme të furnizimit me gaz natyror nuk përfshihen në këtë Rregull.

##### **Neni 3**

##### **Struktura**

1. Kjo Rregull përmban:
  - 1.1. parimet dhe elementet e Marrëveshjes për Kyçje;
  - 1.2. kyçjen në sistem;
  - 1.3. shfrytëzimin e sistemit;

- 1.4. termat dhe kushtet e Kontratës për Furnizim, duke përfshirë Shërbimin Universal dhe Furnizimin e Garantuar;
  - 1.5. qasjen në pronë të konsumatorit;
  - 1.6. leximin e njehsorëve dhe faturimin;
  - 1.7. pagesën e faturave;
  - 1.8. shfrytëzimin e paautorizuar të energjisë; dhe
  - 1.9. kompensimin e konsumatorëve për mos përmbushjen e kushteve të përgjithshme të furnizimit.
2. Format e standardizuara të aplikacioneve për kyçje dhe furnizim, oferta për kyçje dhe kontrata për furnizim të përgatitura nga ndërmarrja e energjisë, do të dorëzohen për miratim në Zyrën e Rregullatorit për Energji (“ZRRE”), dhe do të publikohen në faqen elektronike zyrtare të ndërmarrjes së energjisë.

#### Neni 4

#### Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë rregull, kanë kuptimin si në vijim:
  - 1.1. **Marrëveshja për Aderim** - dokumenti i nënshkruar nga të gjitha palët të cilat janë pajtuar që t’iu përmbahen Rregullave të Tregut;
  - 1.2. **Taksa e aplikimit**- taksa që mbulon shpenzimet administrative të operatorit të sistemit për procedimin e aplikacionit për kyçje, të publikuar nga furnizuesi pas miratimit të ZRRE-së;
  - 1.3. **Periudha e faturimit** – ka kuptimin sipas definimit të dhënë në kodin e matjes
  - 1.4. **Marrëveshja për kyçje** - marrëveshja ndërmjet operatorëve të sistemit dhe shfrytëzuesve të sistemit, që përshkruan procedurën e kyçjes dhe pagesës për kyçje, fillimin e kyçjes, mirëmbajtjen, operimin dhe përfundimin e kyçjes në sistem;
  - 1.5. **Kontrata për furnizim** - marrëveshja ndërmjet furnizuesit dhe konsumatorëve finalë;
  - 1.6. **Metodologjia e taksave për kyçje**- metodologjia e zhvilluar nga operatorët e sistemit, në përputhje me Nenin 7 të kësaj rregulle;
  - 1.7. **Taksa e kyçjes** - taksa që do të paguhet nga shfrytëzuesit e sistemit për kyçje në rrjet;
  - 1.8. **Energjia** - çdo formë e prodhuar ose e përfitur e energjisë (energji elektrike, energji termike ose e gazit natyror) me qëllim të furnizimit ose shitjes;
  - 1.9. **Ndërmarrja e energjisë**-person fizik apo juridik përgjithësisht i organizuar si shoqëri aksionare që kryen një apo më shumë veprimtari të licencuara të prodhimit, transmetimit, shpërndarjes, furnizimit, tregtimit, tregut të oragnizuar të energjisë dhe është përgjegjës për detyrat komerciale, teknike ose të mirëmbajtjes që ndërliken me veprimtaritë e cekura, por nuk përshinë konsumatorin fundor.;
  - 1.10. **Marrëveshja Kornizë e Rregullave të Tregut** - marrëveshja ndërmjet operatorëve të sistemit dhe shfrytëzuesve të sistemit, sipas së cilës Rregullat e Tregut bëhen detyruese

- në mes palëve (më tutje **Marrëveshja Kornizë**);
- 1.11. **Rrjeti** - infrastruktura e nevojshme për transmetimin ose shpërndarjen e energjisë (energjisë elektrike ose ngrohjes);
  - 1.12. **Pala Aplikuese** - pala e cila aplikon që të jetë palë nënshkruese e Marrëveshjes për Aderim;
  - 1.13. **Furnizues** - ndërmarrje e energjisë që kryen veprimtarinë e furnizimit;
  - 1.14. **Sistemi** - një sistem që shërben për transmetim dhe shpërndarje të energjisë elektrike ose energjisë termike për klientët;
  - 1.15. **Operatori i sistemit** - operatori i licencuar i sistemit të transmisionit apo shpërndarjes së energjisë elektrike dhe operatori i licencuar i sistemit të shpërndarjes së ngrohjes;
  - 1.16. **Shfrytëzuesi i sistemit** - personi fizik ose juridik që jep ose merr energji në dhe nga sistemi i rrjetit të transmisionit dhe/ose shpërndarjes;
  - 1.17. **Shfrytëzim i paautorizuar i energjisë** nënkupton shfrytëzimin e energjisë ashtu siç është e përcaktuar në kreun e VIII të kësaj rregulle;
  - 1.18. **Shfrytëzimi i pa kontraktuar**—shfrytëzimi i energjisë siç është përcaktuar në nenin 28 paragrafi 1 të kësaj rregulle;
2. Termat tjerë të përdorur në këtë rregull, kanë të njëjtin kuptim si në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, Ligjin për Energjinë, Ligjin për Energjinë Elektrike, Ligjin për Energjinë Termike dhe Ligjet tjera në fuqi në Kosovë.

## KREU II

### PARIMET E PËRGJITHSHME, TË DREJTAT DHE OBLIGIMET

#### Neni 5

#### Furnizimi me energji elektrike

1. Në përputhje me dispozitat e kësaj rregulle, të gjithë konsumatorët kanë të drejtën dhe obligimin që të:
  - 1.1. kenë trajtim të drejtë dhe jo diskriminues gjatë furnizimit me energji elektrike nga furnizuesit, si dhe të kenë qasje të hapur në informata nga furnizuesi;
  - 1.2. kërkojnë kyçje të objekteve dhe pajisjeve të tyre energjetike në rrjetin e operatorit të sistemit, nëse një kyçje e tillë është teknikisht e mundur, sipas dispozitave të Kodit të Rrjetit ose Shpërndarjes, ndonjë kodi ose rregulle tjetër në fuqi;
  - 1.3. kenë marrëdhënie kontraktuese transparente me furnizuesin;
  - 1.4. paraqesin ankesa sipas dispozitave të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
  - 1.5. paguajnë për energjinë e shfrytëzuar, sipas kontratës për Furnizim me Energji të lidhur me Furnizuesin e Energjisë, si dhe për tarifatat për shfrytëzim të sistemit të miratuara nga ZRRE-ja;
  - 1.6. marrin kompensim nga furnizuesi, për energjinë e pa-dërguar ose për furnizim me energji të cilësisë së dobët dhe shërbim , që nuk është në përputhje me kontratën për furnizim me energji dhe standardet e furnizimit dhe shërbimit që iu ofrohen konsumatorëve.
2. **Furnizuesi** duhet të:
  - 2.1. nënshkruajë marrëveshjen kornizë ose marrëveshjen për aderim me Operatorin e Sistemit të Tregut;
  - 2.2. nënshkruajë marrëveshjen për kyçje me operatorët e sistemit në emër të konsumatorëve;
  - 2.3. zbatojë dispozitat e kësaj rregulle, kodet teknike dhe çdo rregull tjetër në fuqi;
  - 2.4. faturojë dhe arkëtojë (mbledh) pagesat prej konsumatorëve;
  - 2.5. hartojë kontratat, faturat, deklaratat dhe njoftimet që u adresohen konsumatorëve;
  - 2.6. themelojë një departament përgjegjës për mbrojtjen e konsumatorëve, ofrimin e informacioneve, përkrahjen dhe këshillimin e tyre;
  - 2.7. mbajë dhe azhurnojë (rifreskojë) të dhënat për matjen, faturimin dhe pagesën e faturave, aplikacionet për furnizim ose modifikim, marrëveshjet e nënshkruara për shkyçje, kontratat për furnizim, ose të dhëna tjera të nevojshme, ashtu siç

- përcaktohet në këtë rregull dhe në kodet përkatëse;
- 2.8. merret me ankesat e konsumatorëve sipas dispozitave të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
  - 2.9. ofrojë konsumatorëve shërbime në përputhje me Standardet e Kualitetit të furnizimit dhe shërbimit me energji elektrike dhe rregullat tjera në fuqi;
  - 2.10. të dorëzojë te ZRrE-ja për shqyrtim dhe miratim, një përmbledhje të të drejtave dhe obligimeve të konsumatorëve që duhet të jenë në dispozicion të konsumatorëve;
  - 2.11. sigurojë konsumatorëve, një përmbledhje me shkrim mbi të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre, e në veçanti në kohën e nënshkrimit apo ndryshimit të Kontratës së Furnizimit;
  - 2.12. që paraprakisht të paraqesë për rishikim dhe miratim në ZRRE, formën e Kontratës për Furnizim që iu është ofruar konsumatorëve;
  - 2.13. sigurojë informacione për konsumatorët në emër të operatorit të sistemit.
3. **Operatori i Sistemit** duhet të:
- 3.1. zbatojë dispozitat e kësaj rregulle, kodet teknike dhe rregullat tjera në fuqi;
  - 3.2. përgjigjet brenda tridhjetë (30) ditësh ndaj çdo aplikimi për kyçje që është dorëzuar nga shfrytëzuesit e sistemit;
  - 3.3. të zhvillojë një metodologji të përcaktimit të çmimeve dhe taksave të kyçjes dhe ta dorëzojë te ZRRE për miratim;
  - 3.4. të zhvillojë marrëveshjet standarde të kyçjes në pajtim me kodin relevant të rrjetit;
  - 3.5. bëjë kyçjen në rrjet të çdo aplikuesi nëse kjo kyçje është teknikisht e mundshme sipas kushteve të vendosura në marrëveshjen e bërë me një furnizues i cili aplikon në emër të konsumatorit, dhe ta ngarkojë me taksë të përcaktuara në pajtim me metodologjinë të përcaktimit të taksave të kyçjes.
  - 3.6. të publikojë në faqen elektronike zyrtare Metodologjinë e përcaktimit të Taksave për Kyçje të aprovuar nga ZRRE;
  - 3.7. mirëmbajë kyçjet dhe rrjetin në përputhje me dispozitat e kodeve teknike dhe marrëveshjeve përkatëse për kyçje;
  - 3.8. arkëtojë prej shfrytëzuesve të sistemit taksat për shfrytëzim të sistemit;
  - 3.9. sigurojë lexim të saktë dhe të rregullt të njehsorëve;
  - 3.10. hartojë ofertat për kyçje,
  - 3.11. mbajë dhe azhurnojë të dhënat në lidhje me matjen, kyçjen, marrëveshjet për kyçje, aplikacionet për kyçje dhe për ndryshime të kyçjes; faturimin ndaj shfrytëzuesve të sistemit, ndërprerjet e paplanifikuara dhe të planifikuara në furnizim dhe përputhshmërinë me kriteret e cilësisë dhe të gjitha të dhënat e tjera në përputhje me dispozitat e rregullave tjera në fuqi;
  - 3.12. shqyrtojë ankesat me shkrim në lidhje me çështjet e njehsorëve;
  - 3.13. testojë dhe riparojë kyçjet dhe njehsorët;
  - 3.14. sigurojë furnizuesit me informacione në lidhje me kyçjen dhe shfrytëzimin e sistemit;

- 3.15. shmangë çdo diskriminim gjatë ofrimit të shërbimeve;
4. Furnizuesit janë të detyruar që në pajtim me këtë rregull të hartojë procedura në lidhje me kushtet për furnizim me energji, brenda nëntëdhjetë (90) ditë pas marrjes së licencës. Të gjitha këto metodologji/procedura duhet të jenë transparente dhe jo diskriminuese dhe t'i paraqiten ZRRE-së për shqyrtim dhe miratim, dhe të publikohen në faqen zyrtare elektronike.
  5. Oerator i sistemit është i detyruar që në pajtim me këtë rregull të hartojë metodologji/procedura në lidhje me kushtet për kyçjen në sistem, brenda nëntëdhjetë (90) ditë pas marrjes së licencës. Të gjitha këto metodologji/procedura duhet të jenë transparente dhe jo diskriminuese dhe t'i paraqiten ZRRE-së për shqyrtim dhe miratim, dhe të publikohen në faqen zyrtare elektronike

## Neni 6

### Furnizimi me energji termike

1. Të gjithë konsumatorët fundorë brenda një zone të shërbyer nga furnizuesi publik kanë të drejtë, që nëse është teknikisht e mundur, të gëzojnë shërbimin e furnizimit me energji termike prej rrjeteve të ndërmarrjeve të energjisë termike të cilat kryejnë shërbime publike me çmime të rregulluara nga ZRRE, në përputhje me këtë rregull.
2. Të gjithë konsumatorët fundorë brenda një hapësire të shërbyer nga një rrjet i shpërndarjes së ngrohjes ku nuk aplikohet Obligimi i Furnizimit Publik do të kenë të drejtën të kyqen në rrjetin e ngrohjes nëse teknikisht dhe ekonomikisht është e arsyeshme në pajtim me këtë rregull dhe me Kodin e Shpërndarjes, si dhe me kodet dhe rregullat tjera në fuqi.
3. Në përputhje me dispozitat e kësaj rregulle, të gjithë konsumatorët kanë të drejtën dhe obligimin që të:
  - 3.1. kenë trajtim të drejtë dhe jo diskriminues gjatë furnizimit me energji termike, si dhe të kenë qasje të hapur në informata nga furnizuesi;
  - 3.2. kenë marrëdhënie kontraktuese transparente me furnizuesin;
  - 3.3. paraqesin ankesa sipas dispozitave të Rregullës mbi Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë, kundër çdo akti të paligjshëm ose anashkalimi nga ana e furnizuesit;
  - 3.4. paguajnë për energjinë termike të shpenzuar, sipas kontratës për Furnizim me Energji Termike të lidhur me Furnizuesin, si dhe sipas tarifave të miratuara nga ZRRE-ja;
  - 3.5. marrin kompensim nga furnizuesi, për energjinë e pa-dërguar ose për furnizim ose shërbim të cilësisë së dobët, që nuk është në përputhje me kontratën për furnizim me energji dhe standardet e furnizimit dhe shërbimit që iu ofrohen konsumatorëve.
4. Furnizuesit duhet që:
  - 4.1. nënshkruajë marrëveshjen për kyçe me operatorin e sistemit të shpërndarjes së energjisë termike në emër të konsumatorëve;
  - 4.2. zbatojë dispozitat e kësaj rregulle, kodet teknike dhe çdo rregull tjetër në fuqi;

- 4.3. faturojë dhe arkëtojë (mbledh) pagesat prej konsumatorëve;
  - 4.4. hartojë ofertat, kontratat, faturat, deklaratat dhe njoftimet që u adresohen konsumatorëve;
  - 4.5. themelojë një departament përgjegjës për mbrojtjen e konsumatorëve, ofrimin e informacioneve, përkrahjen dhe këshillimin e tyre;
  - 4.6. mbajë dhe azhurnojë (rifreskojë) të dhënat për matjen, faturimin dhe pagesën e faturave ose të dhënave tjera të nevojshme, ashtu siç përcaktohet në këtë rregull dhe në kodet përkatëse;
  - 4.7. merret me ankesat e konsumatorëve sipas dispozitave të Rregullës mbi Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
  - 4.8. ofrojë konsumatorëve shërbime dhe furnizimi sipas standardeve dhe rregullave përkatëse në fuqi;
  - 4.9. të dorëzojë te ZRrE-ja për shqyrtim dhe miratim, një përmbledhje të të drejtave dhe obligimeve të konsumatorëve që duhet të jenë në dispozicion të konsumatorëve;
  - 4.10. sigurojë konsumatorëve, një përmbledhje me shkrim mbi të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre, e në veçanti në kohën e nënshkrimit apo ndryshimit të Kontratës së Furnizimit;
  - 4.11. që paraprakisht të paraqesë për rishikim dhe miratim në ZRRE, formën e Kontratës për Furnizim që iu është ofruar konsumatorëve;
  - 4.12. sigurojë informacione për konsumatorët në emër të operatorit të sistemit
5. **Operatori i Sistemit** duhet të:
- 5.1. zbatojë dispozitat e kësaj rregulle, kodet teknike dhe rregullat tjera në fuqi;
  - 5.2. përgjigjet ndaj çdo aplikimi për kyçe brenda tridhjetë (30) ditësh nga data e dorëzimit;
  - 5.3. të zhvillojë një metodologji të përcaktimit të çmimeve dhe tarifave të kyçjes dhe ta dorëzojë te ZRRE për miratim;
  - 5.4. të zhvillojë marrëveshjet standarde të kyçjes në pajtim me kodin e rrjetit të shpërndarjes dhe kodet e rregullat tjera në fuqi;
  - 5.5. bëjë kyçjen e çdo aplikuesi për kyçe në sistem nëse kjo kyçe është teknikisht dhe ekonomikisht e mundur sipas kushteve të vendosura në marrëveshje të bërë me një furnizues i cili aplikon në emër të një konsumatori dhe ta ngarkojë me tarifa të përcaktuara në pajtim me metodologjinë të përcaktimit të çmimeve dhe tarifave të kyçjes
  - 5.6. të publikojë në web faqen zyrtare Metodologjinë e përcaktimit të Tarifave për Kyçe të aprovuar nga ZRrE;
  - 5.7. mirëmbajë kyçjet dhe rrjetin në përputhje me dispozitat e kodeve teknike dhe marrëveshjeve përkatëse për kyçe;
  - 5.8. sigurojë lexim të saktë dhe të rregullt të njehsorëve;
  - 5.9. mbajë dhe azhurnojë të dhënat në lidhje me kyçjen, marrëveshjet për kyçe, aplikacionet për kyçe dhe për ndryshime të kyçjes; faturimin ndaj shfrytëzuesve të



- sistemit, ndërprerjet e paplanifikuara dhe të planifikuara në furnizim dhe përputhshmërinë me kriteret e cilësisë dhe të gjitha të dhënat e tjera në përputhje me dispozitat e rregullave tjera në fuqi;
- 5.10. shqyrtojë ankesat me shkrim në lidhje me çështjet e njehsorëve;
  - 5.11. testojë dhe riparojë kyçjet dhe njehsorët;
  - 5.12. sigurojë furnizuesit me informacione në lidhje me kyçjen dhe shfrytëzimin e sistemit;
  - 5.13. shmangë çdo diskriminim gjatë ofrimit të shërbimeve;
6. Sezoni i ngrohjes fillon prej datës 15 tetor të vitit aktual deri me 15 prill të vitit të ardhëshëm; në varësi të kushteve klimatike, sezoni i ngrohjes mund të shkurtohet ose zgjatet (furnizim i jashtëzakonshëm me energji termike).
  7. Sezoni i ngrohjes mund të zgjatet maksimalisht nga data 1 tetor deri me 30 prill, duke aplikuar furnizimin e jashtëzakonshëm me ngrohje sipas kushteve në vijim:
    - 7.1. furnizimi i jashtëzakonshëm me ngrohje do të aplikohet në rast se, sipas të dhënave të shërbimeve meteorologjike ose sipas të dhënave prej ndërmarrjeve të energjisë termike, temperatura e jashtme e matur në orën 21:00, në zonën e mbuluar prej ndërmarrjes së ngrohjes qendrore, për tri ditë rresht regjistrohet më ulët se 12<sup>0</sup>C;
    - 7.2. furnizimi i jashtëzakonshëm me ngrohje do të përfundojë kur sipas të dhënave të shërbimeve meteorologjike ose sipas të dhënave prej ndërmarrjeve të energjisë termike, temperatura e jashtme e matur në orën 21:00 në zonën e mbuluar prej ndërmarrjes së ngrohjes qendrore, për tri ditë rresht regjistrohet më e lartë se 12<sup>0</sup>C.
  8. Sezoni i ngrohjes do të mund të shkurtohet me ndërprerjen e përkohëshme të furnizimit me ngrohje vetëm në rastet kur sipas të dhënave të shërbimeve meteorologjike ose sipas të dhënave prej ndërmarrjes së energjisë termike, temperatura e jashtme e matur në orën 21:00 në zonën e mbuluar prej ndërmarrjes së energjisë termike, për dy ditë rresht regjistrohet 12<sup>0</sup>C ose është më e lartë, dhe kur parashikimet e motit prej shërbimeve meteorologjike parashohin se temperatura për tri ditët në vijim do të jetë më e lartë se 12<sup>0</sup>C.

### KREU III

#### KYÇJA NË SISTEM

##### Neni 7

##### **Parimet e përgjithshme të Metodologjisë së taksave për kyçje**

1. Operatorët e sistemeve duhet të zhvillojnë Metodologjinë e taksave për kyçje në përputhje të plotë me Metodologjitë Tarifore të miratuara nga ZRRE-ja, e që përfshijnë taksat për:
  - 1.1. Kostot paraprake për aktivitetet e nevojshme për të dizajnuar, ndërtuar, komisionuar dhe mirëmbajtur kyçjen, si përgjigje ndaj një aplikimi nga shfrytëzuesit e sistemit;
  - 1.2. instalim të linjave elektrike ose gypave për ngrohje, pajisjeve matëse dhe pajisjeve tjera energjetike për qëllim të kyçjes në pikat hyrëse ose dalëse në rrjetë;
  - 1.3. aktivitete për kyçje ose modifikim (ndryshim) të sistemit;

- 1.4. Kostot e lidhura me rrethanat kur linjat elektrike, ose gypat për ngrohje, pajisjet energjetike për instalim janë të një madhësie më të madhe se sa është kërkuar për shfrytëzim të rrjetit;
  - 1.5. mirëmbajtje dhe riparim (përfshirë çdo shpenzim kapital) të kërkuar për kyçje;
  - 1.6. shkyçjen nga rrjeti dhe heqjen e pajisjeve (stabilimenteve energjetike, linjave elektrike ose gypave për ngrohje dhe pajisjeve matëse);
2. Metodologjia e Taksave për Kyçje duhet të përmbajë dispozita lidhur me të drejtën e aplikuesve për të bërë ankesë në ZRRE, kundër ofertave për kyçje të ofruara nga operatorët e sistemit.
  3. Metodologjia e Taksave për kyçje duhet të hartohet në atë mënyrë që të mos ketë diskriminim ndërmjet palëve të ngjashme që kyçen në rrjet kur bëhet vënia e taksave për kyçjet e reja ose për zëvendësimin ose ndryshimin e kyçjes ekzistuese.

#### Neni 8

##### **Aplikimi për Kyçje**

1. Bazuar në Metodologjinë e Taksave për Kyçje dhe kodin relevant të rrjetit, aplikuesi dorëzon aplikacionin të furnizuesi i cili e procedon tek operatori i sistemit, .
2. Përrjashtimisht nga paragrafi 1, nëse aplikuesi është gjenerator, atëherë aplikacionin e dorëzon drejtpërdrejt te operatori i sistemit

#### Neni 9

##### **Oferta për Kyçje**

1. Pas regjistrimit të aplikacionit për kyçje/modifikim të kyçjes ekzistuese, Operatori i Sistemit duhet të bëjë veprimet e nevojshme që të studioj kërkesat teknike të kyçjes, nëse është e nevojshme të vizitojë pronat që janë subjekt i aplikimit, dhe të hartojë dhe dërgoi ofertën për kyçje në formë të shkruar, në pajtim me metodologjinë e taksave për kyçje.
2. Oferta për kyçje në rrjetin elektrik duhet të përmbajë të dhënat:
  - 2.1. për punët e nevojshme për të kyçur një shfrytëzues të sistemit në rrjetet ekzistuese të transmisionit ose shpërndarjes si dhe marrjen e pëlqimit të nevojshëm për këtë qëllim; të emërtuar si “ kyçje e cekët”, për aplikuesit, siç është përcaktuar në Metodologjitë e Tarifave dhe në Metodologjinë e Taksave për Kyçje;
  - 2.2. për punët e nevojshme për të kyçur një shfrytëzues të sistemit në rrjetet ekzistuese të transmisionit ose shpërndarjes si dhe marrjen e pëlqimit të nevojshëm për këtë qëllim në rastin kur kërkohet zgjerim ose përforsim në rrjetin e transmisionit ose shpërndarjes, për të rregulluar kërkesën e supozuar ose kriteret për kapacitet të aplikuesit; të definuar si “kyçje e thellë”, për aplikuesit, siç është përcaktuar në Metodologjitë e Tarifave dhe në Metodologjinë e Taksave për Kyçje;

- 2.3. një taksë standarde të kyçjes të përcaktuar në pajtim me Metodologjitë e Tarifave dhe në Metodologjinë e Taksave për Kyçje për aplikuesit që furnizohen nga një nivel i caktuar tensioni dhe që bien brenda kufijve të ngarkesës dhe distancës maksimale të caktuar nga rrjeti ekzistues i shpërndarjes;
  - 2.4. për instalimin e njehsorëve të përshtatshëm të kërkuar që mundësojnë matjen e energjisë elektrike ose ngrohjes nga operatori i sistemit, në pikat hyrëse dhe dalëse;
  - 2.5. për instalimin e ndërprerësve ose pajisjeve tjera sipas kërkesës;
  - 2.6. për instalimin, aty ku kërkohet, të njehsorëve interval meteometri ose pajisjeve për procesim të të dhënave me qëllim që t'iu mundësoj aplikuesve të cilët janë të detyruar që t'i kenë këto pajisje, për të qenë në përputhje me Rregullat e Tregut.
3. Në rastet e kyçjes në rrjetin e shpërndarjes së energjisë termike, oferta për kyçje duhet të përmbajë:
- 3.1 të dhënat për punët e nevojshme për të kyçur një konsumatorë / shfrytëzues të sistemit, si dhe marrjen e pëlqimit të nevojshëm për këtë qëllim;
  - 3.2 një taksë të kyçjes të përcaktuar në pajtim me Metodologjitë e Tarifave dhe në Metodologjinë e Taksave për Kyçje;
  - 3.3 të dhënat për instalimin e njehsorëve të përshtatshëm të kërkuar që mundësojnë matjen e energjisë termike nga operatori i sistemit të shpërndarjes në pikën hyrëse në rrjetin e shpërndarjes (kjo vlen për shfrytëzuesit e sistemit);
  - 3.4 të dhënat për instalimin e pajisjeve tjera përkatëse të nevojshme për realizimin e kyçjes dhe për operim të sigurt të rrjetit;
- 3.1. .
4. Përveç kërkesave të parashtruara në paragrafin 3 të këtij neni, oferta për kyçje duhet të përmbajë, gjithashtu kushtet teknike të kyçjes të cilat i bashkëngjiten ofertës dhe të cilat duhet të përcaktojnë:
- 4.1. parametrat teknik të sistemit të ngrohjes qendrore;
  - 4.2. vendndodhjen e nënstacionit brenda ndërtesës së Konsumatorit, duke specifikuar pikën e kyçjes dhe mënyrën e kyçjes në tubacionin e furnizimit;
  - 4.3. kufijtë e pronësisë së instalimit brenda nënstacionit;
  - 4.4. rrjedhjen e projektuar të fluidit bartës të ngrohjes dhe tabelat e rregullimit;
  - 4.5. kriteret që kanë të bëjnë me nënstacionin për sa i përket kriterëve specifike të ndërtimit për nënstacionet, specifikimi i pajisjeve të nënstacionit dhe vendndodhjet e valvuleve për kontrollin e rrjedhjes, njehsorin e ngrohjes dhe njehsorin për ujin e trajtuar që furnizon sistemin dytësor;
  - 4.6. kriteret në lidhje me instalimin e brendshëm të ngrohjes
5. Në përpilim të një oferte për kyçje ose të një përgjigje ndaj një aplikacioni për kyçje, operatori i sistemit duhet të vendosë:
- 5.1. datën në të cilën duhet kompletuar punët për të cilat është e nevojshme leja për qasje në rrjet;

- 5.2. taksat përkatëse) që duhet paguar në lidhje me shërbimet e kërkuara të cilat duhet të jenë në pajtueshmëri me Metodologjinë e taksave për kyçje;
  - 5.3. kushtet tjera të detajuara për çdo shërbim të kërkuar për qëllim të marrëveshjes.
6. Për qëllim të përcaktimit dhe vendosjes së taksës të kostove të kyçjes në proporcion me kostot që janë shkaktuar direkt ose indirekt gjatë kryerjes së punëve sipas marrëveshjes për kyçje ose ndryshimin e një kyçjeje ekzistuese, Operatori i Sistemit duhet të marrë parasysh masën me të cilën:
    - 6.1. përfitimi nga kyçja do të jetë në dispozicion të të tjerëve, shfrytëzuesve të tanishëm dhe/ose të ardhshëm të sistemit, palëve të treta të cilat shërbehen nga operatori i sistemit;
    - 6.2. mbledhë përqindjen e këtyre kostove prej shfrytëzuesve të sistemit të tanishëm dhe të ardhshëm ose prej palëve të treta, bazuar në përfitimin e përmendur në nënparagrafin 5.1;
    - 6.3. taksat e aplikimit për kyçje duhet të paguhet në tërësi para fillimit të punëve për kyçje.
  7. Asnjë pagesë nuk do bëhet për përforcim të një rrjeti ekzistues të energjisë elektrike nëse kërkesa për ngarkesë të re ose të shtuar nuk kalon 3% të kapacitetit efektiv ekzistues në pikën përkatëse në rrjet.
  8. Oferta për kyçje duhet të lëshohet dhe dërgohet te aplikuesi përmes furnizuesit në afatin kohor që nuk i tejkalon:
    - 8.1. tridhjetë (30) ditë kalendarike prej datës së dorëzimit të aplikacionit për kyçje në rrjetin me tension të ulët;
    - 8.2. nëntëdhjetë (90) ditë kalendarike prej datës së dorëzimit të aplikacionit për kyçje në rrjetin me tension të mesëm ose të lartë;
    - 8.3. tridhjetë (30) ditë kalendarike prej datës së dorëzimit të aplikacionit për kyçje në rrjetin e shpërndarjes së energjisë termike.
  9. Afati i fundit për dorëzim të ofertës për kyçje mund të zgjatet në rast të ndonjë kyçje komplekse që kërkon një studim paraprak teknik për zgjerim të rrjetit, ose për çfarëdo arsye tjetër që është në përputhje me dispozitat e Kodit të Rrjetit ose Shpërndarjes apo kodeve tjera në fuqi. Në këto raste, oferta për kyçje zgjatet edhe për tridhjetë (30) ditë kalendarike.
  10. Në rast se aplikuesi nuk është i kënaqur me kushtet e ofertës për kyçje, Metodologjia e Taksave për Kyçje lejon që aplikuesi të bëjë vetë studimin teknik me shpenzimet e veta, dhe që operatori i sistemit do të bëjë të mundur lehtësimin e një studimi të tillë përmes dhënies së informacioneve të nevojshme, për të cilat mund të vendoset një taksë e përshtatshme.

## Neni 10

### Refuzimi për Kyçje

1. Operatori i Sistemit mund të refuzoj të kyçë një aplikues përkohësisht, vetëm nëse ajo kyçje nuk është në përputhje me dispozitat e Kodit të Rrjetit dhe Shpërndarjes ose kodeve tjera në fuqi.

2. Në rast të refuzimit të kyçjes, Operatori i Sistemit lëshon dhe dërgon tek aplikuesi një njoftim në formë të shkruar që paraqet arsyen e refuzimit brenda periudhës që nuk tejkalon tridhjetë (30) ditë kalendrike prej datës së dërgimit të aplikacionit, përkatësisht brenda afatit përfundimtar të përcaktuar në Nenin 9 paragrafi 8 të kësaj rregulle.
3. Një operator sistemi do të refuzoj të kyç një aplikues në rast se nuk ka kapacitetet të mjaftueshëm të rrejtit, por nuk do të refuzojë një kyçje për një aplikues mbi bazën që nuk ka kapacitet të mjaftueshëm të gjenerimit të lidhur me rrejtin.
4. Operatori i Sistemit nuk ka të drejtë të refuzojë kyçjen e një centrali të ri për arsye të kufizimeve të mundshme të kapaciteteve të rrejtit në dispozicion, siç mund të jetë kongjestioni në pjesët më të largëta të rrejtit, por duhet t'i ofrojë mundësi të kyçjes në pikën më të afërt të mundshme.

#### Neni 11

##### **Marrëveshja për Kyçje**

1. Brenda periudhës kohore të specifikuar në ofertën për kyçje, aplikuesi pranon ofertën duke i dërguar furnizuesit draft marrëveshjen e nënshkruar për kyçje, dhe paguan taksat përkatëse për kyçje në përfitim të operatorëve të sistemit.
2. Marrëveshja për kyçje përmbyllet në ditën e dërgimit të saj të nënshkruar te operatori i sistemit.
3. Marrëveshja për kyçje duhet të:
  - 3.1. përfshijë parimet themelore për taksat për kyçje të vendosura në Nenin 7 të kësaj rregulle;
  - 3.2. përmbajë elementet lidhur me ofertën për kyçje, sipas Nenit 9 të kësaj rregulle;
  - 3.3. përfshijë afatet në lidhje me fillimin, taksat, kushtet e pagesës (nëse e nevojshme), zgjidhjen e kontesteve dhe kushtet e ndërprerjes së marrëveshjes;
  - 3.4. përfshijë standardet dhe kërkesat minimale të sigurisë, kërkesat në lidhje me vulosjen (bllombimin) e pajisjeve matëse dhe mbylljen me dry të vendit ku janë instaluar ndërprerësit, pajisjet matëse, transformatorët dhe qarqet matëse.
4. Pozitat e njehsorëve do të dakordohen nga përfaqësuesi i Operatorit të Sistemit dhe Konsumatorit në pajtim me standardet teknike dhe kodet relevante.

#### Neni 12

##### **Kyçja**

1. Me nënshkrimin e marrëveshjes për kyçje, operatori i sistemit duhet të realizoj kyçjen siç është specifikuar në atë marrëveshje.
2. Me realizimin e kyçjes, operatori i sistemit duhet të lëshoj raport që konfirmon që kyçja është bërë në përputhje me afatet dhe kushtet e marrëveshjes për kyçje, dhe atë raport duhet ta

paraqesë të shfrytëzuesit e sistemit.

3. Kyçja e realizuar e shfrytëzuesve fundor në pajtim me dispozitat e lartshënuara do të mbetet e vlefshme në rast të çdo ndryshimi të statusit të furnizuesit nëse marrëveshja për kyçje nuk është ndërprerë.
4. Kyçja e Konsumatorit do të aktivizohet (lëshohet) vetëm me udhëzim të shkruar nga Furnizuesi dhe të dërguar te Operatori i Sistemit, me të cilën konfirmon se është nënshkruar Kontrata për Furnizim dhe janë plotësuar të gjithë kriteret për furnizim.
5. Mirëmbajtja e elementeve të kyçjes së thellë do të jetë përgjegjësi e operatorëve të sistemit të Transmisionit ose Shpërndarjes, sipas kushteve të përshkruara në Metodologjinë e Taksave të Kyçjes. Operatori i Sistemit të energjisë elektrike do të jetë i autorizuar të vendosë një taksë fillestare të përshtatshme për kostot e kapitalizuara të mirëmbajtjes së kyçjeve të cekëta që aplikohen në mënyrë jo-diskriminuese ndaj të gjithë shfrytëzuesve të këtyre kyçjeve.
6. Neni 12, paragrafi 5, i kësaj rregulle nuk do të aplikohet ndaj kyçjeve ekzistuese që janë në pronësi të konsumatorëve. Për mirëmbajtjen e këtyre kyçjeve, operatorët e sistemit do të ngarkojnë konsumatorët në mënyrë të vazhdueshme sipas çmimoreve të miratuara nga ZRRE-ja, dhe me tarifa të cilat do të mund të rregullohen në mënyrë të përshtatshme. Mirëmbajtja e kyçjes përfshinë mirëmbajtjen e kabllave/përçuesve të lidhur në rrjetin e operatorit, aparaturat matëse dhe siguresat hyrëse (nëse aplikohen) të kutive matëse. Kjo do të mund të kryhet vetëm nga operatorët e sistemit të Transmisionit ose Shpërndarjes.
7. Konsumatorët që kanë në pronësi të tyre pika kyçjeje, përfshirë aparaturat matëse, mund t'i transferojnë asetet e tyre tek operatorët e sistemit pa asnjë kompensim pas sjelljes së tyre në gjendje të rregullt siç kërkohet në kodet teknike të nxjerra nga operatorët e sistemit dhe miratuara nga ZRRE-ja. Prej datës kur do të bëhet transferimi i këtyre aseteve nga konsumatorët, do të aplikohen dispozitat e paragrafi 5 të këtij neni. Asetet e transferuara do të përfshihen në bazën e aseteve të operatorit të sistemit që shfrytëzohet për qëllimet e miratimit të tarifave të rregulluara nga ZRRE-ja, në përputhje me parimet e përcaktuara në Metodologjitë e Tarifave.
8. Në rast kur konsumatorët do të shfrytëzojnë dispozitën e paragrafi 6 të këtij neni, Operatori i Sistemit mund të kërkojë rregullimin e tarifës në përputhje me Rregullën mbi Parimet e Llogaritjes së Tarifave në Sektorin e Energjisë Elektrike. Transferimi i mundshëm i aseteve që përcaktohet në Nenin 12, paragrafi 7 të kësaj rregulle, do të merret në shqyrtim në përputhje me Metodologjitë e Tarifave për Sektorin e Energjisë të miratuara nga ZRRE.
9. Në rast të rrjeteve të ngrohjes qendrore, një konsumator mund të kyçet madje edhe kur nuk ka matje në (lokalet)objektin e konsumatorit dhe furnizuesi duhet të ofrojë një metodologji për përcaktimin e kostove ndaj këtij konsumatori në tarifa normative të bazuara në terrenin e (lokaleve)objekteve të konsumatorëve, por operatori i sistemit do të bëjë përpjekje të arsyeshme për të instaluar matjen në objekte.

## KREU IV

### SHFRYTËZIMI I SISTEMIT

Neni 13

#### **Parimet themelore të kostove të shfrytëzimit të sistemit**

Taksat për shfrytëzim të sistemit janë të përcaktuara në Parimet e përcaktimit të Tarifave për Operatorët e Sistemit të miratuara nga ZRRE.

Neni 14

#### **Aderimi në shfrytëzimin e Sistemit të Transmisionit**

Me qëllim të shfrytëzimit të Sistemit të Transmisionit, Pala Aplikuese do të jetë nënshkruese e Marrëveshjes Kornizë ose do të nënshkruajë Marrëveshjen për Aderim me Operatorin e Tregut në rolin e vet si Palë e Autorizuar sipas Marrëveshjes Kornizë (tani e tutje “Pala e Autorizuar”).

Neni 15

#### **Marrëveshja Kornizë për rregullat e tregut të energjisë**

Palët e Autorizuara do të nënshkruajnë Marrëveshjen Kornizë me të cilën Rregullat e Tregut bëhen obliguese për palët në atë marrëveshje.

## KREU V

### KONTRATAT PËR FURNIZIM

#### Neni 16

#### Aplikimi për Furnizim

1. Aplikacioni për furnizim duhet të dorëzohet nga aplikuesit tek furnizuesi me qëllim që të lidhet kontrata për furnizim.
2. Konsumatorëve u kërkohet një aplikacion për furnizim në rast se ata ndryshojnë furnizuesin.. Në rast se Konsumatori nuk është në përputhje me kriteret minimale komerciale, të sigurisë dhe mbrojtjes që janë përshkruar në Nenet 8, 9, 11 dhe 12 të kësaj rregulle, kyçja ekzistuese do të shkyçet në një datë të dakorduar që do t'i mundësojë Konsumatorit kyçje të re alternative në përputhje me kriteret e sipërpërmendura. Procedurat dhe formularët për konsumatorët që dëshirojnë të ndërrojnë furnizuesin janë të definuara në rregullën e adoptuar dhe të publikuar nga ZRRE dhe janë vënë në dispozicion për konsumatorët nga secili furnizues sipas kërkesës.
3. Furnizuesi është i obliguar që të regjistroj çdo aplikacion për furnizim.
4. Furnizuesi me obligim të ofrimit të shërbimit universal do të pranojë aplikacionin e aplikuesit që siguronse konsumatori është në përputhje me kërkesat minimale komerciale dhe të sigurisë sikurse përshkruhet në nenet 8, 9, 11 dhe 12 të kësaj rregulle. Furnizuesi shqyrton aplikacionin brenda tri (3) javëve pas pranimit të aplikacionit dhe nxjerr njoftim me shkrim në lidhje me qëndrimin e vet për të pranuar ose refuzuar aplikacionin. Ky afat kohor mund të zgjatet për (15) ditë kalendrike të tjera në rastet kur kërkohen informata shtesë. Aplikuesi duhet të informohet me shkrim rreth zgjatjes së afatit.
5. Kur konsumatori është një konsumator i energjisë termike dhe furnizuesi ka një obligim të furnizimit publik për sa i përket rrjetit të energjisë termike në të cilin konsumatori dëshiron të kyçet atëherë furnizuesi do të pranojë aplikacionin me kusht që konsumatori të përshtatet me kërkesa minimale komerciale, të sigurisë sikurse përshkruhen në nenet 8, 9, 11 dhe 12 të kësaj rregulle. Furnizuesi shqyrton aplikacionin brenda tri (3) javëve dhe nxjerr njoftim me shkrim në lidhje me qëndrimin e vet për të pranuar ose refuzuar aplikacionin. Ky afat kohor mund të zgjatet për (15) ditë kalendrike të tjera në rastet kur kërkohen informata shtesë. Aplikuesi duhet të informohet me shkrim rreth zgjatjes së afatit.
6. Furnizuesi duhet të zhvillojë dhe paraqesë për miratim te ZRRE-ja procedurat në lidhje me kriteret për aplikuesit ose konsumatorët që të demonstrojnë aftësi pagese të kënaqshme për shërbime të reja ose vazhdim të shërbimeve, përfshirë çfarëdo kërkesë ose marrëveshje për pagesën e një depozite garancie sipas Nenet 24 të kësaj rregulle.
7. Aplikacioni për furnizim mund të refuzohet nëse aplikuesi nuk është në gjendje të paraqesë



aftësi pagese të pranueshme sipas kësaj rregulle dhe politikave të miratuara nga Bordi i ZRRE-së.

8. Nëse një aplikuesit i refuzohet shërbimi i furnizimit, aplikuesi mund të fillojë kontestin në përputhje me Rregullën për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në sektorin e energjisë. .
9. Konsumatorët mund të ndërrojnë furnizuesin brenda njëzetënjë (21) ditësh pas njoftimit të furnizuesit të tyre aktual dhe nuk ka pagesë për ndërrimin e tillë. Konsumatorët e energjisë elektrike do të kenë të drejtë të kontraktjnë me më shumë se një furnizues siç është përcaktuar në nenin 46 paragrafi 7 të Ligjit për Energjinë Elektrike, por me kusht që për secilin furnizues të ketë njëhisor të veçantë.
10. Ndryshimi i furnizuesit nga konsumatorët do të bëhet në pajtim me procedurat e ndërrimit të furnizimit të miratura nga Zyra e Rregullatorit për Energji.

#### Neni 17

##### **Kontrata për Furnizim**

1. Kontrata për furnizim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Furnizuesi dhe Konsumatori, dhe kyçja do të realizohet nga Operatori i Sistemit brenda një periudhe kohore e cila nuk i tejkalon dy (2) ditë kalendarike. Pas kësaj bëhet njoftimi i pranimit të kyçjes dhe vërtetimi për përputhshmërinë me kriteret e kyçjes nga Operatori i Sistemit.
2. Furnizuesi do t'u komunikojë me shkrim Konsumatorit dhe Operatorit të Sistemit datën e fillimit të kontratës për furnizim. Përfaqësuesi i autorizuar i Operatorit të Sistemit do të bëjë kyçjen e re, ose do të bëjë përmirësimin e kyçjes ekzistuese me anë të një udhëzimi me shkrim nga ana e furnizuesit.
3. Për modifikimin e kontratave ekzistuese për furnizim do të aplikohet procedura e vendosur në Nenin 16, dhe bazuar në Nenin 9 të kësaj rregulle.

#### Neni 18

##### **Specifikat e Marrëdhënies kontraktuese në rastet e furnizimit me energji termike**

1. Në sistemin e ngrohjes qendrore, Konsumatori - pala kontraktuese konsiderohet shfrytëzuesi i autorizuar i ndërtesës së pajisur me nënstacion termik dhe me rrjet dytësor / instalim të brendshëm të ngrohjes qendrore në ndërtesë.
2. Në rast të ndërtesave me shumë kate të cilat përbëhen nga apartamente të shumta në pronësi individësh të cilët janë shfrytëzuesit fundorë të energjisë termike, varësisht nga dizajni i rrjetit dytësor, Konsumatori – pala kontraktuese e furnizuesit mund të konsiderohet një entitet ligjor që përmbush detyrat e veta të administrimit shtëpiak (p.sh. administrator, shoqata banesore, etj.) i cili do të krijohet në të ardhmen.
3. Deri në krijimin e administratës banesore në ndërtesat shumëkatëshe çdo pronar i apartamenteve do të konsiderohet si një Konsumator – palë kontraktuese e Furnizuesit.

Neni 19

**Obligimi për Furnizim**

1. Secili furnizues publik i energjisë termike është i detyruar që të furnizojë me energji sipas një tarife të rregulluar çdo konsumator që gjendet në zonën e mbuluar nga i licencuari për furnizim, dhe që është i kyçur në rrjet në përputhje me marrëveshjen për kyçje dhe në bazë të dispozitave të kontratës për furnizim, dhe duke ju nënshtruar kritereve të Neneve 8, 9, 11 dhe 12 të kësaj rregulle.
2. ZRRE mund të caktojë Furnizuesin Publik të energjisë termike si furnizues të mundësisë së fundit për sa i përket të gjithë konsumatorëve të lidhur me rrjetin e ngrohjes dhe Furnizuesi Publik atëherë bëhet palë-përgjegjëse ndaj të gjitha kontratave për furnizim të bëra me konsumatorin në tarifën e pajtuara me ZRRE-në të cilat mundësojnë furnizuesit publik të mbulojnë shpenzimet shtesë të dala gjatë ofrimit të këtij shërbimi.
3. Furnizuesi i energjisë elektrike që ka obligim të Shërbimit Universal të Furnizimit është i obliguar që të furnizojë çdo konsumator me të drejtë të furnizimit universal e që është i kyçur si duhet në pajtim me marrëveshjen e kyçjes dhe mbi bazën e dispozitave të kontratës së furnizimit dhe që i nënshtrohet kërkesave të neneve 8, 9, 11 dhe 12. Tarifa e aplikueshme për Furnizim Universal duhet të vendoset në pajtim me Ligjin për Energjinë elektrike dhe mund të rregullohen për një periudhë të limituar të kohës me një vendim nga ZRRE të bërë në pajtim me Ligjin.
4. Furnizuesi i Mundësisë së Fundit i caktuar nga ZRRE sipas nenit 40 të Ligjit për energjinë elektrike është i obliguar të furnizoj konsumatorët që mbesin pa furnizues në rastet kur:
  - 4.1. Furnizuesi i tyre ka bankrotuar ose është nën likuidim;
  - 4.2. Licenca e furnizuesit të mëparshëm është revokuar në mënyrë të përkohshme ose të përhershme, ose ka skaduar;
  - 4.3. Konsumatori ka dështuar të përzgjedh një furnizues të ri pas ndërprerjes së kontratës me furnizuesin e mëparshëm.
5. Furnizuesi që nuk ka qenë në gjendje të furnizojë me energji elektrike të gjithë konsumatorët fundorë, sikurse në rastin e përshkruar në paragrafin 4.1 të këtij neni, do të obligohet ta informojë në afat të duhur Furnizuesin e Mundësisë së Fundit, konsumatorin fundorë, ZRRE-në dhe operatorët e transmisionit apo të shpërndarjes për datën e ndërprerjes së furnizimit. Në kesi rasti, konsumatori do të furnizohet menjëherë nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit.
6. ZRRE-ja do ta informojë Furnizuesin e Mundësisë së Fundit, konsumatorin fundorë, operatorët e sistemit të transmisionit dhe shpërndarjes për furnizuesin që bien nën paragrafin 4.2 të këtij neni, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë nga data kur licenca e përmendur ka skaduar, ose nga data e hyrjes në fuqi të vendimit të ZRRE-së që të revokojë të përkohshme ose të përhershme licencën.

7. Kontratat mbi furnizimin e garantuar për konsumatorët fundorë duhet të bëhen në datën në të cilën përmbushen kushtet për të ushtruar të drejtën për furnizim të garantuar, sikurse në nënparagrafin 4.1 dhe 4.2 të këtij neni.
8. Furnizimi i garantuar në rastet e përcaktuara në nënparagrafet 4.3 të këtij neni duhet të nisnin pas ndërprerjes së kontratës me furnizuesin e mëparshëm ose pas nisjes së furnizimit për konsumatorët e rinj, që varet, sidoqoftë, nëse kontrata nuk nënshkruhet me një furnizues tjetër.
9. Furnizimi i garantuar nuk duhet të zgjas më shumë se gjashtëdhjetë (60) ditë.
10. Në rast se konsumatori fundorë nga nënparagrafi 4.3 të këtij neni është i furnizuar nga furnizuesi i mundësisë së fundit, dështon të arrijë marrëveshje me furnizuesin e ri brenda afatit të përcaktuar në paragrafin 9 të këtij neni, operatori i sistemit do ta ndërpres furnizimin e energjisë elektrike.
11. Operatori i sistemit të transmisionit dhe operatori i sistemit të shpërndarjes duhet të dorëzojnë informatat për Furnizuesin e Mundësisë së Fundit te konsumatorët e transferuar për furnizimi të garantuar, brenda pesë (5) ditëve të njoftimit sipas paragrafëve 5 dhe 6 të këtij neni.
12. Çmimet sipas të cilave Furnizuesi i Mundësisë së Fundit furnizon me energji elektrike përcaktohen sipas metodologjisë së hartuar, miratuar dhe publikuar nga ZRRE...
13. Furnizuesi i Mundësisë së Fundit duhet të obligohet për të njoftuar konsumatorin për afatet dhe kushtet e furnizimit dhe çmimeve të furnizimit me energji elektrike, si dhe informon konsumatorin për të drejtën e tij për ndërrimin e furnizuesit.. Ai duhet të publikojë këto kushte dhe informacione në faqen e tij elektronike zyrtar.
14. Furnizuesi i Mundësisë së Fundit i dorëzon kontratën konsumatorit fundorë brenda tetë (8) ditëve nga fillimi i furnizimit.
15. Furnizuesi i mundësisë së fundit publikon në faqen elektronike, së paku një herë në vit, informatat mbi numrin e konsumatorëve të furnizuar, sasinë totale të energjisë elektrike të livruar, periudhën mesatare të furnizimit, ndaras për konsumatorët familjar dhe ata jofamiljar që gëzojnë të drejtën e furnizimit në kuadër të shërbimit universal.

#### Neni 19A

#### **Obligimet e furnizuesve të energjisë elektrike**

1. Furnizuesi duhet të informojë konsumatorët e tij:
  - 1.1. Në një mënyrë të qartë dhe transparente për çmimet e aplikueshme, kushtet standarde dhe afatet për shfrytëzimin e shërbimeve të tij;
  - 1.2. Për mundësitë e ndryshme të pagesës, të cilat nuk diskriminojnë ndërmjet konsumatorëve.

Mënyrat e parapagimit duhet të jenë të drejta dhe të reflektojnë në masë adekuate konsumin e mundshëm. Të gjitha dallimet në kushte dhe afate duhet të reflektojnë shpenzimet e furnizuesit në lidhje me mënyrat e ndryshme të pagesës;

- 1.3. Për të drejtat e tyre për të përzgjedhur dhe ndryshuar furnizuesin, pa pagesë;
- 1.4. Për mundësinë e shfrytëzimit të procedurave të thjeshta dhe efektive për trajtimin e ankesave, si dhe secili furnizues duhet të sigurohet që të gjithë konsumatorët e tij kanë të drejtë për një standard të mirë të shërbimit dhe trajtim të ankesave me mundësinë e zgjidhjes së kontesteve në një mënyrë të drejtë dhe brenda afateve të përcaktuara në Rregullën për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë ;
- 1.5. Për konsumin dhe shpenzimet aktuale të energjisë elektrike, në mënyrë që t'u mundësohet atyre të menaxhojnë konsumin e tyre të energjisë elektrike. Këto informata duhet të ofrohen brenda një afati të arsyeshëm, që merr parasysh funksionet e njehsorëve elektrik të instaluar, me vëmendjen e duhur ndaj shpenzimeve të atyre masave, si dhe pa i ngarkuar konsumatorët fundorë me shpenzime shtesë për shërbime të tilla;
- 1.6. Për çfarëdo ndryshime në kushtet e kontratës, së paku pesëmbëdhjetë (15) ditë para aplikimit të tyre, duke përfshirë të drejtën e tyre për tu tërhequr pas një njoftimi të tillë. Furnizuesit i njoftojnë konsumatorët e tyre drejtpërdrejt për çfarëdo rritje në shpenzime dhe për të drejtën për tu tërhequr nga kontrata në rast se ata nuk i pranojnë kushtet e reja të ofruara në njoftim;
- 1.7. Përmes faturave dhe materialeve promovuese të ofruara për konsumatorët fundorë në lidhje me:
  - 1.7.1 Kontributin e secilit burim të energjisë në prodhimin e gjithëmbarshtëm të energjisë nga lëndët mikse djegëse që Furnizuesi i ka shfrytëzuar në vitin paraprak, dhe këto të paraqiten në një mënyrë gjithëpërfshirëse, dhe në nivel shtetëror, në një mënyrë të qartë të krahasueshme;
  - 1.7.2 referencën ndaj burimeve ekzistuese të informacionit, si faqeve elektronike, në të cilat informatat mbi ndikimin në mjedis të furnizimit mund të gjenden, së paku nga aspekti i emetimeve CO2 dhe mbetjeve radioaktive që rrjedhin nga prodhimi i energjisë elektrike, nga përzjerja e përgjithshme e lëndëve djegëse gjatë vitit paraprak për prodhimin e energjisë elektrike të shfrytëzuar nga furnizuesi;
  - 1.7.3 Të drejtat e tyre për sa i përket zgjidhjes së mosmarrëveshjeve;
  - 1.7.4 Të dhënat për konsumin e tyre, që iu mundësojnë atyre, me pajtim të shprehur dhe pa pagesë, të ofrojnë ndërmarrjes së regjistruar të furnizimit qasje në të dhënat e matura;
  - 1.7.5 Obligimin për pagesën finale, duke i dhënë konsumatorit llogarinë përfundimtare të përmbyllur në rast të çfarëdo ndryshimi të furnizuesit të energjisë elektrike, kjo duhet të bëhet jo më vonë se katërdhjetëepesë (45) ditë pasi që ka ndodhur një ndryshim i tillë;
  - 1.7.6 Për sa i përket nënparagrafit 1.7.1 dhe 1.7.2 të këtij neni në lidhje me energjinë elektrike të ofruar nga furnizuesi nëpërmjet shkëmbimeve të energjisë elektrike ose importeve nga ndërmarrjet që ndodhen jashtë Komunitetit të Energjisë, mund të shfrytëzohen numrat total të ofruar nga ndërmarrjet e lartpërmendura

për shkëmbimit e energjisë elektrike për vitin paraprak.

- 1.8. Furnizuesi gjithashtu duhet të:
  - 1.8.1 Publikojë dhe mirëmbajë parametrat cilësorë të furnizimit të kontraktuar të energjisë elektrike për konsumatorët, në pajtim me rregullat për cilësinë e furnizimit, të miratuara nga ZRRE;
  - 1.8.2 Furnizojë konsumatorët me energji elektrike sipaskontratës së nënshkruar;
  - 1.8.3 Mirëmbajë të dhëna të ndara në regjistrat komerciale për furnizimin e konsumatorëve me çmime të parregulluara, dhe furnizimin e konsumatorëve me çmime të rregulluara, për furnizimin nën kornizën e shërbimit universal dhe furnizimit të garantuar;
  - 1.8.4 Përcaktojë kushtet e furnizuesit dhe bëjë ato publike në një mënyrë të duhur, jo më vonë se tridhjetë (30) ditë para nisjes së aktiviteteve të furnizimit me energji elektrike;
  - 1.8.5 Realizojë aktivitete e furnizimit me energji në një mënyrë të sigurt, të qëndrueshme dhe efëciente;
  - 1.8.6 Ofrojë konsumatorit, në bashkëpunim me ZRRE-në, një kopje të listave kontrolluese të konsumatorëve të energjisë elektrike, sikurse është vendosur nga Komisioni Evropian dhe adoptuar nga Grupi i Përhershëm i Nivelit të Lartë i Komunitetit të Energjisë.
2. Para fillimit të furnizimit secili furnizues gjithashtu ka obligim të:
  - 2.1. lidhë kontratë për balancim me Operatorin e Sistemit të Transmetimit ose të lidh kontratë anëtarësimi në grupin e balancimit me udhëheqësin e këtij grupi në përputhje me Rregullat e Tregut;
  - 2.2. lidhë kontratë për blerje të energjisë elektrike me së paku një furnizues tjetër, furnizues ose prodhues si dhe të lidhë kontratë për furnizim me konsumatorin fundor dhe, nëse është e nevojshme, të sigurojë kapacitete transmetuese ndërkufitare
3. Furnizuesit me obligime të shërbimit publik për të furnizuar konsumatorët fundorë të cilët gëzojnë të drejtën e shërbimit universal do të themelojnë mekanizmat e nevojshëm për të përkrahur konsumatorët në nevojë, pas konsultimit me ZRRE, në mënyrë që të shmanget ndërprerja e energjisë elektrike për shkak të mospagesës së faturave.
4. ZRRE-ja duhet të ndërmerret të gjitha hapat e nevojshëm për të siguruar që informatat e ofruara nga furnizuesi për konsumatorët e tij të jenë të besueshme dhe lehtë të krahasueshme.
5. Furnizuesi mund të furnizojë nëpërmjet mjeteve matëse për hapësira të përbashkëta, vetëm nëse një person fizik ose juridik nënshkruan një kontratë dhe pranon të paguajë për një kapacitet të tërë, energjinë elektrike, shërbimet e shpërndarjes dhe të transmissioinit të kryera nëpërmjet mjetit matës. ZRRE-ja mund të rregullojë afatet dhe kushtet mbi bazën e së cilave do të kryhet pagesa nga personi që merr pagesën në emër të shfrytëzueses të hapësirës së përbashkët dhe mund të vë taksa për personat e tjerë që përfitojnë nga energjia elektrike.

6. Çdo person që kyçet në sistemin e shpërndajres dhe shfrytëzon energjinë elektrike pa pasur kontratë me furnizuesin duhet të shkyçet nga sistemi i shpërndarjes, në pajtim me rregullën për shkyçje të miratuar nga ZRRE.

#### Neni 19B

##### **Obligimet e furnizuesit publik të energjisë termike**

1. Furnizuesi Publik duhet të:
  - 1.1. Ekskluzivisht të furnizojë konsumatorët me energji termike, me tarifa të rregulluara, në pajtim me kushtet e licencës dhe kërkesat e vendosura në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë;
  - 1.2. Hyj në kontrata me të gjithë konsumatorët, duke përfshirë konsumatorët (finalë)fundorë, mbi furnizimin me energji termike, në pajtim me rregullat e vendosura nga ZRRE, dhe në pajtim me nenin 25 të Ligjit për Energjinë Termike;
  - 1.3. Përgatis dhe dorëzojë fatura dhe mbledh pagesat nga konsumatorët e tij, vendos mekanizmat e nevojshëm për përkrahjen e konsumatorëve të cenuar, në konsultim me ZRRE;
  - 1.4. Hartojë, dorëzojë faturat dhe mbledh pagesat nga konsumatorët e tij dhe ndërmarrjet e tjera të energjisë. Ky faturim dhe mbledhje monitorohet nga ZRRE, sipas Ligjit për Rregullatorin e Energjisë ose ligjeve të tjera të aplikueshme dhe licencave, kodeve apo rregulloreve sipas nevojës;
  - 1.5. Ofrojë informata të rregullta për konsumatorët e tij në raport me çështjet e ndërlidhura me furnizimin e tyre me energjinë termike, duke përfshirë informatat mbi karburantin, çështjet e mjedisit dhe informatat për të drejtat e konsumatorëve në zgjidhjen e ankesave dhe kontesteve.

#### Neni 19C

##### **Kërkesat kontraktuale për konsumatorët fundorë**

1. Të drejtat dhe obligimet e ndërsjella të furnizuesit të shërbimeve të energjisë elektrike dhe konsumatorit i nënshtrohen një kontrate të nënshkruar.
2. Kontrata e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni duhet të përmbajë, përveç elementeve të përgjithshme të vendosura në Ligjin për Marrëdhëniet e Detyrimeve, elementet si në vijim:
  - 2.1. Identitetin dhe adresën e furnizuesit;
  - 2.2. Shërbimet e ofruara, duke përfshirë kohën e kyçjes fillestare dhe nivelet e cilësisë së shërbimeve të ofruara;

- 2.3. Llojet e ofruara të shërbimeve të mirëmbajtjes;
  - 2.4. Çfarëdo kompensimi sipas rregullave të rimbursimit të cilat aplikohen në rast se nuk arrihen nivelet e kontraktuara të cilësisë së shërbimeve, duke përfshirë faturimin e pasaktë ose të vonuar;
  - 2.5. Mënyrat në të cilat mund të merret informacioni i përditësuar mbi të gjitha tarifat dhe shpenzimet e mirëmbajtjes;
  - 2.6. Mënyrat për njoftimin e ndryshimit të çmimeve dhe kushteve të shërbimit të energjisë elektrike;
  - 2.7. Kohëzgjatja e kontratës, kushtet për ripërtëritjen apo ndërprerjen e kontratës, si dhe të drejtat dhe obligimet në rast të anulimit dhe ndërprerjes së marrëveshjes, duke përfshirë edhe informatat nëse lejohet tërheqja pa pagesë nga kontrata;
  - 2.8. Mënyrat për iniciimin e procedurave për zgjidhjen e ankesave dhe kontesteve;
  - 2.9. Informatat për të drejtat e konsumatorëve;
  - 2.10. Të drejtat dhe obligimet e ofruesit të shërbimeve të energjisë elektrike dhe konsumatorit në rast të dështimit në përmbushjen e obligimeve të tyre dhe në rast të ndërprerjes së përkohshme të dërgimit (shpërndarjes);
  - 2.11. Elementët e tjerë, varësisht nga karakteri i veçantë dhe lloji i shërbimeve të ofruara të energjisë elektrike.
3. Dispozitat kontraktuale po ashtu do të përmbajnë të drejtat dhe obligimet e konsumatorëve, në gjuhë të qartë, të thjeshtë, dhe padykptimësi.
  4. Informatat për kushtet e kontratës duhet t'i ofrohen konsumatorëve sa më shpejt që është e mundur, por jo më vonë se para përmbylljes së kontratës. Kushtet dhe afatet e përgjithshme duhet të jenë të drejta dhe transparente. Ato duhet të ofrohen në gjuhë të qartë dhe të kuptueshme, dhe të mos përmbajnë pengesa jokontraktuale për ushtrimin e të drejtave të konsumatorëve. Konsumatorët duhet të mbrohen nga metodat e shitjeve jo të drejta dhe mashtrimeve.
  5. Në rastet kur kontratat nënshkruhen nëpërmjet ndërmjetësve, informatat për sa i përket çështjeve të deklaruara në paragrafin 4 të këtij neni, duhet po ashtu të ofrohen para përmbylljes së kontratës.
  6. Konsumatorët mund të kenë më shumë se një kontratë për një pikë të caktuar të shpërndarjes për një periudhë të njëjtë furnizimi.
  7. Për konsumatorët e energjisë elektrike në kontratën e furnizimit me energji elektrike nuk duhet të ketë ndonjë dispozitë që mund të pengojë të drejtën e konsumatorit për të ndërruar furnizuesin, derisa kontrata nuk duhet të imponojë obligime financiare shtesë. .

Neni 19D

### **Mbrojtja e konsumatorëve të energjisë elektrike**

1. Konsumatori fundorë gëzon mbrojtjen e të drejtave të tij në pajtim me legjislacionin në fuqi, aktet nënligjore të lëshuara bazuar në ligje, si dhe legjislacionin që rregullon mbrojtjen e konsumatorit.
2. Ndalohen sjelljet e pahijshme dhe të padrejta dhe aktivitetet mashtruese në kuptimin e mbrojtjes së konsumatorit, derisa kushtet dhe afatet e ofruara për nënshkrim të kontratës të jenë transparente dhe të shkruara në gjuhë të qartë dhe të kuptueshme.
3. Gjatë kryerjes së aktiviteteve të tij, furnizuesi duhet të veprojë në një mënyrë që siguron trajtimin e barabartë të konsumatorëve.
4. Konsumatori ka të drejtë të:
  - 4.1. marrë të gjitha informatat e deklaruar me këtë rregull;
  - 4.2. marrë njoftimin adekuat për synimin e modifikimit të kushteve të kontratës, si dhe informimin për të drejtën e tyre të tërheqjes kur jepet ai njoftim. Ofruesit e shërbimit I njoftojnë drejtpërdrejt konsumatorët e tyre, për çfarëdo rritje në shpenzime, në kohën e përshtatshme, jo më vonë se tridhjetë (30) ditë pasi rritja ka hyrë në fuqi, në mënyrë transparente dhe gjithëpërfshirëse. Konsumatorët kanë të drejtë të tërhiqen nga kontrata nëse nuk i pranojnë kushtet e reja që iu njoftohen atyre nga ofruesi i shërbimit të energjisë. ;
  - 4.3. pranojë informata transparente për çmimet dhe tarifat e aplikueshme dhe kushtet e afatet standarde, në lidhje me qasjen dhe shfrytëzimin e shërbimeve të energjisë.  
;
  - 4.4. marrë ofertën për një zgjedhje të gjerë të metodave të pagesës, të cilat nuk bëjnë diskriminim të paarsyeshëm mes konsumatorëve. Sistemi i parapagimit duhet të jetë i drejtë dhe të reflektojë në masë adekuate konsumin e mundshëm. Secili dallim në kushte e afate duhet të reflektojë shpenzimet e furnizuesit në sisteme të ndryshme të pagesës. Kushtet dhe afatet e përgjithshme duhet të jenë të drejta dhe transparente. Ato duhen ofruar në gjuhë të qartë dhe të kuptueshme si dhe nuk do të përmbajnë barriera jokontraktuese ndaj ushtrimit të të drejtave të konsumatorit. Konsumatori duhet mbrojtur nga metodat e padrejta apo shtrembëruese të shitjes. .
  - 4.5. Të mos paguaj për ndërrimin e furnizuesit (e aplikueshme për konsumatorët e energjisë elektrike);
  - 4.6. Të përfitojë nga procedurat transparente, të thjeshta, për trajtimin e ankesave të tyre. Specifikisht, të gjithë konsumatorët duhet të kenë të drejtë për një standard të mirë të shërbimit dhe trajtimit të ankesave nga ofruesit e shërbimeve të energjisë. Këto procedura jogjyqësore për zgjidhjen e kontesteve do të ofronin një zgjidhje të drejtë dhe të shpejtë të mosmarrëveshjeve, në mënyrë të preferueshme brenda tre (3) muajsh, me ofrimin, kurdo që kërkohet, të një sistemi të rimbursimit dhe/apo kompensimit.
  - 4.7. Të informohet për të drejtat e tij të ndërlidhura me shërbimin universal, kurdo që ka qasje në shërbimet universale e aplikueshme për konsumatorët e energjisë elektrike).
  - 4.8. Të ketë të dhëna në dispozicion për konsumin e tij dhe të jetë në gjendje, me pajtim të shprehur dhe pa pagesë, të ofrojë te ndërmarrja e licencuar për furnizim, qasje në



- të dhënat matëse. Rregullatori duhet të përcaktojë formatin e të dhënave dhe procedurave si për furnizuesit ashtu dhe për konsumatorët që të kenë qasje në të dhëna. Konsumatorët nuk duhet t'iu nënshtrohen shpenzimeve të tjera për këto shërbime:
- 4.9. Të informohet me kohë për konsumin dhe shpenzimet aktuale të energjisë, ashtu që të jetë në gjendje të rregullojë konsumin e tij vetanak. Informatat e tilla duhet të ofrohen në një kohë të caktuar, duke pasur parasysh kapacitetin e pajisjeve matëse të konsumatorit dhe produktet energjisë në fjalë. Duhet të merret parasysh edhe efikasiteti në kosto i atyre masave. Konsumatorët nuk do t'iu nënshtrohen asnjë pagese shtesë për shërbime të tilla;
  - 4.10. Marrë llogarinë përfundimtare të mbylljes pas ndërrimit të furnizuesit të energjisë elektrike, jo më vonë se dyzetë e pesë (45) ditë pas kryerjes së ndërrimit të furnizuesit
5. Sistemet inteligjente të njehsimit, që mundësojnë pjesëmarrjen aktive të konsumatorëve në tregun e furnizimit me energji elektrike, mund të vendosen, duke pasur në konsideratë si në vijim:
- 5.1. zbatimin e sistemeve të tilla të njehsimit apo matjes që i nënshtrohet një vlerësimi ekonomik të të gjitha shpenzimeve dhe përfitimeve afatgjate për tregun dhe konsumatorin individual, apo të formës së matjes inteligjente të energjisë elektrike që është ekonomikisht e arsyeshme dhe efektive në kosto, si dhe afatit që është i arsyeshëm për shpërndarjen e tyre. Vlerësimi i tillë do të bëhet deri më 1 janar 2020. Sipas atij vlerësimi, Rregullatori përgatit një tabelë afatesh me cak deri në dhjetë (10) vjet për zbatimin e sistemeve inteligjente të matjes;
  - 5.2. nëse instalimi i njehsorëve të energjisë elektrike inteligjentë vlerësohet pozitivisht, së paku tetëdhjetë (80%) e konsumatorëve do të pajisen me sisteme inteligjente të matjes deri më 2025
6. përqin ZRRE-ja duhet të sigurojë ndërveprim ndërmjet sistemeve matëse të zbatuara në territorin e saj, dhe, në këtë aspekt, të merr parasysh shfrytëzimin e standardeve relevante dhe praktikave të mira, si dhe rëndësinë e zhvillimit të tregut të brendshëm të energjisë.
7. ZRRE-ja duhet të kujdeset që të sigurojë dispozitat për ofrimin një pikë të vetme të kontaktit për të gjitha informatat e nevojshme për sa i përket të drejtave të konsumatorëve, legjislacionin aktual dhe mënyrat e në zgjidhjes së ankesave dhe kontesteve. Pika e tillë e kontaktit mund të jetë pjesë e pikave të përgjithshme të informimit për konsumatorët.
8. Për trajtimin efikase jashtëgjyqësore të kontesteve duhet të funksionojë një organ për konsumatorin cili i përgjigjet drejtpërdrejt Bordit të ZRRE-së.

Neni 19E

### **Mbrojtja për konsumatorët e energjisë elektrike në nevojë**

1. Konsumatorët familjarë të cilët e kanë pranuar vendimin mbi statusin e tyre të konsumatorit në nevojë sociale, kanë të drejtë në mbrojtje të veçantë në përputhje me nenin 49, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për Energjinë Elektrike.
2. Konsumatorët në nevojë kanë të drejtë për shërbim furnizimi sipas këtij neni për aq kohë sa

janë plotësuar kushtet nga paragrafi 1, dhe 2 të nenit 49 të Ligjit për Energjinë Elektrike, që duhet të verifikohen së paku çdo gjashtë (6) muaj nga autoriteti përgjegjës për mirëqenien sociale. Nëse, për shkak të ndryshimit të rrethanave një konsumator humb statusin e konsumatorit me status në nevojë sociale ai duhet të fshihet nga regjistri përkatës, por të dhënat e tij do të mbeten në dispozicion për një periudhë prej pesë (5) vitesh pas regjistrimit të tij në regjistër. Operatori i shpërndarjes të sistemit duhet, të njoftojë me shkrim konsumatorin në nevojë, brenda tetë (8) ditësh, dhe furnizuesin e tij për sa i përket fshirjes së tij nga regjistri.

3. Një furnizues me obligime të shërbimeve publike do të obligohet që të ofrojë një kontratë furnizimi për të gjithë konsumatorët në nevojë të energjisë elektrike dhe të fillojë furnizimin pa vonesa pasi që konsumatori në nevojë të dorëzojë një kërkesë të shoqëruar me dëshmi për përmbushjen e kërkesave nga paragrafi 1 i këtij neni.
4. Operatorët e sistemit të shpërndarjes do të krijojnë dhe mirëmbajnë një regjistër të konsumatorëve në nevojë. Regjistrat do të përmbajnë emrat dhe mbiemrat e konsumatorit në nevojë, numrin personal të identifikimit të konsumatorit, adresën ku ai/ajo furnizohet me energji elektrike, numrin nën të cilin ai/ajo listohet, llojin e trajtimit të veçantë të cilin ka të drejtë ta ketë ai/ajo dhe përfitimet që u jepen atij/asaj nën statusin e konsumatorit në nevojë. Të dhënat nga regjistri mund t'i prezantohen vetëm konsumatorit në nevojë që ka aplikuar për regjistrim në regjistrin përkatës dhe furnizuesit të tij/saj.
5. Të drejtat dhe obligimet lidhur me konsumatorët në nevojë, të përcaktuar në paragrafët 1, dhe 2 të nenit 49 të Ligjit për Energjinë Elektrike, do të zbatohen si duhet nga operatori i sistemit të shpërndarjes. Në veçanti, operatori i sistemit të shpërndarjes do të merr masa të duhura për të mbrojtur konsumatorët fundorë në zonat e largëta të cilat janë të lidhura me rrjetin e energjisë elektrike.
6. Furnizuesi që ofron furnizim me energji elektrike për konsumatorët në nevojë krijon mekanizma për ofrimin e asistencës për konsumatorët në nevojë që synon shmangien e shqyçjes së energjisë elektrike për shkak të faturave të papaguara.

## KREU VI

### QASJA NË PRONË

#### Neni 20

#### Qasja në pronë të Konsumatorit

1. Konsumatori është i obliguar që të ju lejojë qasje në pronën e tij, përfaqësuesve të Operatorit të Sistemit/Furnizuesit, për qëllim të leximit, testimit, inspektimit, instalimit, mirëmbajtjes, riparimit të matësve, kyçjeve dhe pajisjeve përkatëse ashtu si paraqitet në Nenet 28, 29 dhe 30 të Ligjit për Energji.
2. Nëse konsumatori nuk lejon qasje për leximin e pajisjeve matëse edhe pas marrjes së njoftimit me shkrim, energjia e furnizuar do të faturohet bazuar në mesataren e faturave gjatë tre (3) muajve të mëparëshëm.
3. Refuzimi i paarsyeshëm dhe i vazhdueshëm i konsumatorit që t'i lejojë qasje në pronë

ndërmarrjes së energjisë, mund të pasoj shkyçja sipas dispozitave të Rregullës për Shkyçjen dhe Rikycjen e Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë në Kosovë.

## KREU VII

### MATJA, FATURIMI DHE PAGESA

#### Neni 21

##### Leximi i njehsorëve

1. Operatori i Sistemit mund t'ia besojë leximin e njehsorëve furnizuesve ose ndonjë kontraktuesi tjetër. Në këtë rast, Operatori i Sistemit mbetet përgjegjës për të siguruar lexim të saktë dhe të rregullt dhe do të sigurojë që entiteti i kontraktuar për leximin e njehsorëve, do të bëjë lexim të rregullt dhe të saktë të njehsorëve, në përputhje me Kodin përkatës të Matjes. Operatori i Sistemit duhet të krijoj dhe paraqes procedurën për lexim të njehsorëve të konsumatorëve në ZRRE për shqyrtim dhe miratim.
2. Në rast të kërkesës së konsumatorëve, Operatori i Sistemit, është i obliguar që t'i siguroi atij çfarëdo informate në lidhje me rezultatet e leximit të njehsorëve, pa pagesë.

#### Neni 22

##### Testimi i njehsorëve

1. Në rast të kërkesës së Furnizuesit ose Konsumatorit dhe kurdo që është e nevojshme, Operatori i Sistemit është i obliguar të testoj njehsorët. Testimi dhe procedura e testimit të njehsorëve janë të përcaktuara në kodin përkatës të matjes
2. Operatori i Sistemit do të jetë i detyruar t'iu sigurojë furnizuesve çdo rezultat në lidhje me saktësinë e njehsorëve të testuar, dhe nëse është e aplikueshme të bëjë korrigjimin komercial, në përputhje me parimet përkatëse të kësaj rregulle, dhe Kodit të Matjes..

#### Neni 23

##### Faturimi

1. Furnizuesi është i detyruar të sigurojë që konsumatorët të jenë të faturuar për energjinë e shpenzuar r dhe për tarifën tjerë, sipas strukturës tarifore të përcaktuar dhe në përputhje me llojin e tarifës të dakorduar me Konsumatorin (nëse është e aplikueshme).
2. Faturimi i energjisë së shpenzuar zbatohet për çdo periudhë të faturimit duke u bazuar në të dhënat e lexuara nga njehsori dhe të mbledhura nga Operatori i Sistemit ose Furnizuesi ashtu siç është rënë dakord në kontratën për furnizim, oseme tarifa të miratuara nga ZRRE-ja për konsumatorët që gëzojnë të drejtën e shërbimit univerzal dhe furnizuesit të mundësisë së fundit,
3. Në rast të gabimeve që rrjedhin prej të dhënave të leximit të pasaktë të njehsorit, të cilat shkaktojnë faturim të pasaktë, Furnizuesi do të bëjë të gjitha korrigjimet (rregullimet) e nevojshme në faturën vijuese.

4. Faturat duhet të dërgohen në adresën e Konsumatorit që është specifikuar në kontratën për furnizim. Nëse nuk është specifikuar adresa ose është specifikuar në mënyrë të pasaktë ose jo të plotë, ose nëse Konsumatori nuk gjendet më në adresën e specifikuar, Furnizuesi do ta bëjë dërgesën në vendndodhjen fizike ku ka ndodhur shfrytëzimi i energjisë..
5. Faturat duhet/mund të përmbajë pjesëmarrjen e kostove për energjinë shfrytëzuar, për shfrytëzim të rrjetit, dhe kostove tjera. Furnizuesi duhet të paraqesë formë dhe përmbajtje standarde të faturave te Bordi i ZRRE-së për rishikim dhe miratim para se të dërgohen te konsumatorët.

#### Neni 24

##### **Depozitimi i Garancisë**

1. Nëse konsumatorët komercialë dhe familjarë, nuk janë të rregullt në pagesa, me rastin e rikyçjes, furnizuesi ka të drejtë të kërkojë depozitim të garancisë.
2. Depozitimi i Garancisë është një garanci adekuate që do të përllogaritet për të mbuluar faturat e ardhshme të vlerësuara për furnizim me energji për një periudhë prej dy (2) muajsh.
3. Depozitimet e garancisë duhet të paguhen me para në dorë ose përmes xhirollogarisë bankare.
4. Depozitimet e garancisë duhet t'i kthehen Konsumatorit pas ndërprerjes së Kontratës për Furnizim dhe pas rregullimit të borxhit të papaguar nëse ekziston, brenda periudhës njëmuajore nga data e ndërprerjes. Depozitimi i garancisë mund t'i kthehet Konsumatorit pas një viti nëse dëshmohet në pagesat e rregullta të faturave të energjisë për periudhë të pandërprerë prej 12 muajsh.
5. Furnizuesi duhet të paraqesë në ZRRE për miratim procedurën e depozitës së garancisë.

#### Neni 25

##### **Pagesa e faturave**

1. Pagesa e faturave dhe depozitimet e garancisë duhet të bëhet në qendrën e specifikuar për arkëtim nga Furnizuesi çdo ditë të punës gjatë orëve të përshkruara , ose me ndonjë mënyrë tjetër të specifikuar në faturë apo në kontratën për furnizim.
2. Në rast të çfarëdo pagese që i bëhet Operatorit të Sistemit/Furnizuesit për shërbim, konsumatorit duhet t'i lëshohet një dëftesë pagese. Të dhënat lidhur me pagesat duhet të ruhen në një regjistër për të paktën pesë (5) vjet..
3. Furnizuesi duhet të krijoj dhe paraqes procedurën për faturim të konsumatorëve në ZRRE për shqyrtim dhe miratim.
4. Procedura duhet të përmbajë periudhën prej datës së dorëzimit të faturës gjer me datën e afatit të fundit të pagesës, si dhe periudhën pas afatit të lejuar para se të aplikohet kamata për mos pagesë sipas nenit 26 të kësaj rregulle.

5. Periudha prej dorëzimit të faturave të konsumatorët deri të afatit të pagesës së borxhit për të gjitha pagesat aktuale nuk duhet të jetë më pak se pesëmbëdhjetë (15) ditë.
6. Periudha e lejuar pas afatit të fundit kohor para aplikimit të çfarëdo kamate ose interesi nuk do të jetë më pak se njëzetë (20) ditë prej datës së kalimit të afatit të fundit për pagesë.
7. Mos-pranimi i faturës nuk e liron konsumatorin nga obligimi për të paguar.
8. Dorëzimi i çdo ankese në lidhje me saktësinë e faturës, nuk do të suspendoj obligimin e Konsumatorit për të paguar faturën, në të cilin rast Konsumatorit do t'i kërkohet që të bëjë pagesën në përputhje me nenin 19 paragrafi 4 të Rregullës për Shkyçjen dhe Rikyçjen e Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë në Kosovë.

#### Neni 26

##### **Pasojat e Mos-Pagesave**

1. Në rast të mos pagesës furnizuesi ka të drejtë që të rregulloj borxhet e papaguara nga Konsumatori prej depozitimit garantues në çdo kohë. Në raste të tilla, furnizuesi mund të kërkojë nga Konsumatori që të bëjë një depozitë garantuese shtesë.
2. Në rast të mos pagesës brenda periudhës së lejuar, siç përcaktohet në Nenin 25, paragrafi 6 të kësaj rregulle, Konsumatori mund të jetë i detyruar të paguajë kamatë për shumën e borxhit në normë të interesit të caktuar për muaj. Normat e interesit do të miratohen nga ZRRE-ja për çdo vit fiskal sipas kërkesës së furnizuesit.
3. Me vendim të Furnizuesit, këstet mujore për qëllim të shlyerjes së borxhit mund të dakordohen me Konsumatorin, pa paragjykuar detyrimin e Konsumatorit që të paguajë kamatat deri në shlyerjen e plotë të borxhit.
4. Furnizuesi mund të transferoj të dhënat institucioneve tjera, me qëllim të përmirësimit të normës së arkëtimit, ose me kërkesë t'iu dërgojë institucioneve të autorizuara në pajtim me ligjet e aplikueshme. Në rast të transferimit ose dërgimit të të dhënave të konsumatorëve furnizuesi duhet t'i përmbahet të drejtës së Konsumatorit për konfidencialitet të parashikuar nga legjislacioni i aplikueshëm.

#### Neni 27

##### **Shkyçja për mos pagesë**

Shkyçja për mos pagesë mund të zbatohet vetëm si masë e fundit sipas dispozitave të Rregullës për Shkyçjen dhe Rikyçjen e Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë në Kosovë.

## KREU VIII

### SHFRYTËZIMI I PAAUTORIZUAR I ENERGJISË

#### Neni 28

##### Shfrytëzimi i pa kontraktuar

1. Konsumatori do të konsiderohet se shfrytëzon energji në mënyrë të pa kontraktuar nëse:
  - 1.1. shfrytëzon energji në një mënyrë ose në sasi që nuk është si ajo që i është miratuar nga ndërmarrja e energjisë;
  - 1.2. transmeton energji pas pikës matëse, në një vend tjetër, pa lejen e ndërmarrjes së energjisë, dhe ia përçon një shfrytëzuesi tjetër në një vend të ndryshëm nga vendi i kçjes në rrjetë;
  - 1.3. nuk nënshkruan kontratën me furnizuesin e energjisë brenda afatit të dhënë dhe vazhdon të shfrytëzojë energjinë pa kontratë.
2. Konsumatorët nuk duhet të ndryshojnë ose kryejnë ndonjë veprim në kçje, pajisje matëse dhe aparate pa pëlqimin me shkrim nga ndërmarrja e energjisë, dhe janë të obliguar që të raportojnë te furnizuesi sapo të kuptojnë për ndonjë prishje të shkaktuar në kçje dhe në pajisjet matëse.

#### Neni 29

##### Vjedhja e energjisë elektrike

1. Nëse Konsumatori kryen një nga shkeljet si: manipulimin, anashkalimin e matësve të energjisë elektrike, lidhjen ose ri-lidhjen pa autorizim përfurnizim me energji elektrike që transmetohet nga ose përmes një sistemi të transmisionit ose shpërndarjes së energjisë elektrike, konsiderohen si vjedhje e energjisë elektrike, veprime këto që janë të specifikuara në nenin 61 të Ligjit mbi Energjinë Elektrike.

#### Neni 30

##### Vjedhja e energjisë termike

1. Nëse Konsumatori kryen një nga shkeljet si: , manipulimin, anashkalimin e matësve të energjisë termike, lidhjen ose ri-lidhjen pa autorizim në sistemin e shpërndarjes për furnizim me energji termike, konsiderohen si vjedhje e ngrohjes qendrore, ashtu siç specifikohen më poshtë:
  - 1.1. kçje (lidhje) direkte në rrjetin primar të ngrohjes ose në pjesën e rrjetit primar të nënstacionit termik;

- 1.2. kyçje (lidhje) pa autorizim në sistemin sekondar të ngrohjes gjegjësisht në gypat e rrjetit sekondarë në ndërtesë;
- 1.3. largimi dhe/ose dëmtimi i blombave ose vulave të ndërmarrjes së ngrohjes qendrore;
- 1.4. dëmtim apo ndryshimi i dizajnit, funksionit dhe performancës së instalimeve dhe/ose njehsorit të energjisë termike me qëllim të shfrytëzimit të pa-autorizuar; dhe
- 1.5. zgjerim të hapësirës ngrohëse dhe instalimi i trupave ngrohës shtesë pa autorizim nga ndërmarrja e energjisë termike;

#### Neni 31

##### **Llogaritja e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë**

1. Nëse fillimi i shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë nuk mund të përcaktohet, atëherë për konsumatorët familjarë do të merret që shfrytëzimi i paautorizuar i energjisë ka filluar gjashtë (6) muaj para datës kur Konsumatori është gjetur duke bërë shfrytëzim të paautorizuar të energjisë, ndërsaq për konsumatorët tjerë dymbëdhjetë (12) muaj para datës kur Konsumatori është gjetur duke bërë shfrytëzim të paautorizuar të energjisë, ose nga dita e inspektimit të fundit kur instalimi ka qenë në rregull.
2. Për llogaritjen e faturave për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë do të zbatohen tarifat e aplikueshme në datën kur është identifikuar shfrytëzimi i paautorizuar i energjisë, gjegjësisht në datën e përpilimit të procesit nga ekipi i kontrollës, dhe për konsumatorët shtëpiak do të zbatohen tarifat e grupit një-tarifor të ndara sipas sezoneve (verë, dimër), kurse për konsumatorët tjerë do të zbatohet tarifa e lartë e grupit që i përket, gjithashtu të ndarë sipas sezoneve.
3. Ndërmarrja e energjisë (Furnizuesi/OSSH-ja) duhet të paraqesë për miratim në ZRRE procedurën për identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë. Në këtë procedurë duhet të specifikohen:
  - 3.1. llojet e abuzimeve në njehsor dhe ndërhyrjeve në kyçje sipas Nenit 29 të kësaj rregulle, dhe veprimet që duhet të ndërmerr ndërmarrja e energjisë për secilin lloj abuzimi të njehsorit dhe ndërhyrjeve në kyçje;
  - 3.2. veprimet që duhet të ndërmerr ndërmarrja e energjisë në rast të shfrytëzimit të pa kontraktuar të energjisë sipas Nenit 28, paragrafi 1 të kësaj rregulle; dhe
  - 3.3. në llogaritjen e energjisë së shfrytëzuar në mënyrë të paautorizuar sipas Nenit 29, të kësaj rregulle, furnizuesi duhet të zbresë nga fatura e rikthimit të humbjeve energjinë e faturuar gjatë asaj periudhe (nëse ka faturuar).
4. Për rastet që identifikohen si shfrytëzim i paautorizuar i energjisë elektrike nga zyrtarët e autorizuar të OSSH apo rastet e identifikuara nga qendra e kalibrimit, OSSH është e obliguar të veproj konform dispozitave ligjore të përcaktuara me nenin 61 të Ligjit për energjinë elektrike, si dhe dispozitave ligjore siç përcaktohen edhe në kapitullin e XXVI të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.
5. Rastet e identifikuara si në paragrafin 4 të këtij neni, OSSH mund të përpiloi pro faturën e

rikthimit të humbjeve sipas rasteve dhe kategorive të konsumatorëve tarifor e cila pro faturë mund ti shërbejë gjykatës në formë të ekspertizës financiare për dëmin financiar në rast se i është shkaktuar ndërmarrjes së energjisë, por që në asnjë rast në këtë fazë nuk duhet të ngarkohet konsumatori me rikthim të humbjeve në faturat e rregullta mujore.

- 6 Për të gjitha çështjet e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike, ndërmarrja e energjisëduhet të rregulloj mënyrën e procedimit të këtyre rasteve përmes Procedurës së Identifikimit dhe Shfrytëzimit të Paautorizuar të Energjisë Elektrike.

#### Neni 33

### **Kompensimi i Konsumatorëve**

1.Në rast se Furnizuesi dështon në zbatimin procedurave për shkyçje sipas Rregullës për Shkyçje dhe Rikyçje të Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë në Kosovë, konsumatorët e prekur negativisht kanë të drejtë në kompensim prej furnizuesit për dëmet direkte dhe të pranuar si rezultat nga kjo.

2. Furnizuesi duhet të paraqesë për rishikim dhe miratim në ZRRE procedurat për kompensime të tilla.

#### Neni 34

### **Gjobat**

1. Në rastet kur Furnizuesi nuk i përmbush obligimet e tij për nënshkrim të marrëveshjes për kyçje me Operatorin e Sistemit në vend të Konsumatorit, ose nuk e furnizon Konsumatorin në përputhje me kontratën për furnizim, ZRRE ka autoritetin të vejë gjoba për furnizuesin e tillë në përputhje me Nenin 57 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë dhe Rregullën për Masat dhe Gjobat Administrative.
2. Derrogimi i dispozitave të caktuara në kontratën për furnizim mund të lejohet në rastet kur Furnizuesi paraqet te ZRRE-ja arsyen që mund të provojë paaftësinë e përmbushjes të këtyre kërkesave dhe të propozoj masat dhe veprimet që mund të largojnë këto pengesa.

## **KREU IX**

### **DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE**

#### Neni 35

### **Gjuha zyrtare**

Kjo rregull është nxjerrë në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.

#### Neni 36

### **Ndryshimi**



1. ZRRE mban të drejtën që të ndryshoj ose modifikoj çdo dispozitë të kësaj rregulle.
2. Procedurat për ndryshim ose modifikim të kësaj rregulle, do të jenë të njëjta si për miratim të saj.

Neni 37  
**Interpretimi**

Në rast se ka paqartësi për dispozitat e kësaj rregulle, Bordi do të nxjerrë informacione shpjeguese.

Neni 38  
**Shfuqizimi**

Kjo rregull shfuqizon Rregullën për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji të nxjerr në bazë të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr. 03/L-185 dhe të miratuar nga Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji me datë 29 Maj 2011.

Neni 39  
**Hyrja në fuqi**

Kjo rregull hyn në fuqi nga dita e miratimit të saj nga Bordi i ZRRE-së, dhe do të publikohet në faqen zyrtare elektronike të ZRRE-së.

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji:**

---

u.d. Kryesues

---

Anëtar

---

Anëtar